



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 110 / Prot.

Tiranë, më 08.12 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 138, datë 08.12 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Boshnjaku B" Shpk, me NIPT K72627402H, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion objekti nr. 50, godinë 3-kate, hoteli b2k, në Repartin Ushtarak nr.1020, Zall-Herr, Tiranë", me Nr. REF-35890-07-08-2022, me fond limit 67.577.260,8 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 28.07.2022 nga autoriteti kontraktor Reparti Ushtarak Nr. 1001, Komanda e Forcës Tokësore (në vijim "AK").

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Boshnjaku B" Shpk, me NIPT K72627402H, me adresë: Lagjja "Bishanak", Rruga "Skënderbeu", pranë "Bolv Oil", Fier.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

APP është vënë në lëvizje nga një denoncim për nisjen e procedurave ligjore për verifikim për subjektin "Boshnjaku B" Shpk, për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurën sipërcituar të prokurimit.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodhemi në kushtet e nenit 78/1/a të LPP, në të cilin përcaktohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 138, datë 08.12 2022, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Boshnjaku B" Shpk, me NIPT K72627402H, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 5 (pesë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.